



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA MALËSI E MADHE
DREJTORIA E BURIMEVE NJERËZORE DHE SHERBIMEVE MBËSHTETËSE

Nr. _____ prot

Koplik , më _____ .2026

SHPALLJE PËR VEND VAKANT PUNE

Në zbatim të nevojave të institucionit dhe në kuadër të masave për parandalimin dhe monitorimin e zjarreve gjatë sezonit veror, Bashkia Malësi e Madhe shpall hapjen e procedurës së aplikimit për pozicionin:

“Vrojtues për Zjarret” (me kontratë të përkohshme 5-mujore)

1. Përshkrimi i përgjithshëm i punës:

Vrojtuesi për zjarret do të jetë përgjegjës për monitorimin e territorit të përcaktuar, identifikimin në kohë të rasteve të zjarreve dhe njoftimin e menjëhershëm të strukturave përgjegjëse, në përputhje me rregulloret dhe procedurat në fuqi.

2. Detyrat kryesore:

- Kryen vëzhgim të vazhdueshëm në zonat e caktuara për rrezik zjarri
- Raporton në kohë reale çdo vatër zjarri apo rrezik potencial
- Bashkëpunon me strukturat e emergjencave civile dhe zjarrfikëset
- Mban evidenca dhe raporte ditore mbi situatën në terren
- Zbaton rregullat e sigurisë dhe udhëzimet e eprorëve

3. Kriteret e përgjithshme:

- Të jetë shtetas shqiptar
- Të ketë gjendje të mirë shëndetësore dhe aftësi fizike për punë në terren
- Të jetë i gatshëm për punë me turne dhe në kushte të ndryshme atmosferike
- Të karakterizohet nga përgjegjshmëria, korrektësia dhe vigjilenca
- Eksperienca në fusha të ngjashme përbën avantazh

4. Kohëzgjatja e kontratës:

Kontratë pune e përkohshme me afat 5 (pesë) muaj

5. Orari i punës:

Sipas organizimit dhe nevojave të institucionit (mund të përfshijë turne)

6. Dokumentacioni i kërkuar:

- Kërkesë për aplikim
- Kopje e dokumentit të identifikimit (ID)
- Curriculum Vitae (CV), nëse disponohet
- Fotokopje e noterizuar e diplomës së shkollës së mesme
- Vërtetim Banimi
- Raport Mjeko-Ligjor
- Dëshmi Penaliteti
- Numer llogarie Bankare

7. Afati dhe mënyra e aplikimit:

Të interesuarit duhet të dorëzojnë dokumentacionin brenda datës _ 12/ 05/ 2026, pranë zyrave të Bashkisë Malësi e Madhe ose në adresën elektronike zyrtare të institucionit.

Vetëm kandidatët e përzgjedhur do të njoftohen nga Institucioni .